

SHTIGJE EKO-TURIZMI NË ZONËN NDËRKUFITARE PËR PROMOVIMIN E TURIZMIT ALTERNATIV

Konteksti

Kukësi dhe Rahoveci kanë shumë destinacione tërheqëse natyrore dhe kulturore, megjithatë, ende nuk kanë një ofertë turistike të larmishme dhe gjithëpërfshirëse që të kombinojë destinacionet më të mira turistike në zonën ndërkufitare. Kjo ka kufizuar potencialin e zonës për t'u bërë një pikë e nxehtë turistike. Bukuritë natyrore të pashfrytëzuara, ndërjegjësimi i ulët dhe informacioni i pamjaftueshëm për itineraret/shtigjet ekzistuese, hartëzimi joadekuat, mungesa e shërbimeve cilësore, fuqisë punëtore dhe ekspertëve të trajnuar në eko-turizëm, si dhe mungesa e kulturës së turizmit eko te vendasit, kanë penguar zhvillimin e industrisë së turizmit në këtë zonë. Ky projekt synon të lehtësojë bashkëpunimin dhe të inkurajojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të pikave tërheqëse të zonës Kukës-Rahovec për të nxitur rritjen e industrisë së turizmit në zonën ndërkufitare.

Objektivat e Projektit

Objektivat specifike të këtij projekti janë:

- Rinovimi dhe zgjerimi i ofertës turistike, duke krijuar shtigje natyrore dhe kulturore dhe promovuar fshatra të largëta me trashëgimi të rëndësishme;
- Vlerësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, duke theksuar autenticitetin, bukurinë dhe veçantinë e territorit;
- Përmirësimi i aksesit në informacion për vizitorët, duke ofruar informacion digjital të përpiktë mbi shtigjet, kushtet dhe pajisjet e nevojshme;
- Rritja e ekspertizës në turizmin mjedisor dhe punëtorinë artizanale vendase, me fokus tek gratë sipërmarrëse;
- Zhvillimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe institucioneve të sektorit turistik.

Produktet

- Identiteti vizual i markës për promovimin e trashëgimisë në zonën e BK;
- Vendosja e sinjalistikave dhe hartëzimi i 20 km rrugë me mjete digjitale;
- Instalimi i dy mureve të ngjithjes dhe dy shtëpive në pemë;
- Organizimi i dy aktiviteteve kulturore dhe natyrore në natyrë si pjesë e Festivalit të Gjallicës;
- Organizimi i dy konkurseve të tregimtarisë për artistë të rinj;
- Botimi i një libri me tregime të përzgjedhura nga konkursi;
- Zhvillimi i një aplikacioni celular që ofron të dhëna në kohë reale;
- Krijimi i dy guidave turistike që do të ndahen online;
- Krijimi i dhjetë videove promovuese 3D;
- Organizimi i tetë trajnimeve dhe një punëtorie;
- Organizimi i dy panairëve për promovimin e zejeve vendase;
- Zhvillimi i një platforme interaktive për ture.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Komisioni Evropian

PARTNER:

- Bashkia Kukës
- Bashkia Rahovec
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- Green Art Center

KOHËZGJATJA:

15/03/2022 - 14/03/2024

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,

Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

